

Banka e Shqipërisë

ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR

T1 - 2011

SOFIKA NOTE, OLTA MANJANI
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

PRILL 2011

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autoreve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.


P Ë R M B A J T J A

I.	HYRJE	4
II.	NDËRMJETËSIMI I SISTEMIT BANKAR	6
III.	NDËRMJETËSIMI BANKAR SIPAS MONEDHAVE	10
III.1	Ecuria e ndërmjetësimit në lekë	10
III.2	Ecuria e ndërmjetësimit në euro	12
III.3	Ecuria e kritereve jokosto në ndërmjetësim	13
IV.	NDËRMJETËSIMI FINANCIAR NË VENDET E RAJONIT	15
V.	ANEKSI	18

1. HYRJJE

Ndërmjetësit financiarë në një ekonomi lehtësojnë marrëdhënien midis agjentëve ekonomikë në rolin e huadhënësve, kryesisht individë, të cilët depozitojnë kursimet e tyre, dhe agjentëve ekonomikë në rolin e huamarrësve, kryesisht biznese, të cilët i përdorin këto fonde për kryerjen e investimeve. Sikurse në shumicën e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, në Shqipëri sistemi financiar dominohet kryesisht nga sistemi bankar. Aktualisht, sistemi bankar shqiptar përbëhet nga 16 banka universale private, ku dominon kapitali i huaj, i cili përbën rreth 92% të kapitalit të mbajtur të sistemit bankar. Në fund të muajit shkurt 2011, portofoli i kredisë përbën 49% të aktivitetit të sistemit bankar, ndërkohë që depozitat zënë rreth 78% të pasivit. Mesatarisht rreth 50% e aktivitetit ndërmjetësues të sistemit bankar – rreth 60% e aktivitetit depozitues dhe 40% e aktivitetit kreditues – mbulohet nga grupi i përbërë prej tre bankave më të mëdha dhe dominuese të tregut (grupi B1 në grafik).

Grafik 1. Peshat e grup-bankave* në totalin e depozitave dhe kredisë së sistemit bankar.



*Analiza e grup-bankave bazohet mbi aktivitetin ndërmjetësues të 9 bankave më aktive në tregun e kredidhënies, të cilat përbëjnë rreth 91% të aktiveve të sistemit bankar. Ndarja e bankave në grupe është bazuar në madhësinë e bilancit të bankave si dhe karakteristikat e financimit të veprimitarisë së tyre. Më konkretisht ato përfaqësojnë: B1- 3 bankat më të mëdha të sistemit; B2- 3 bankat greke; B3- 3 bankat e vogla të sistemit bankar aktive në kredidhënie. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet në tremujorin e parë¹ të këtij viti tregojnë për zgjerim të lehtë të tregut të depozitave të grupit të parë B1, ku pesha e tyre në treg nga 59 % që shënonte në fund të vitit 2010, arriti në rreth 59.7 % në fund të muajit shkurt 2011. Megjithatë, në një hark kohor më të gjatë vërehet një tkurrje e tregut të depozitave të këtij grupi bankar në vite.

Ndërsa aktiviteti depozitues në grupet B2 dhe B3 ka ruajtur thuajse të njëjtën ecuri me një tremujor më parë. Grupi i bankave B2 ka shënuar një rritje të lehtë të aktivitetit depozitues gjatë dy muajve të parë të vitit kundrejt

¹ Analiza e ndërmjetësimit financiar përfshin periudhën janar-shkurt '11.

fundit të vitit të kaluar. Kjo rritje është materializuar në zgjerimin e peshës së depozitave të këtij grupi ndaj totalit të sistemit në 19.9% në muajin shkurt, nga 19.7% që ishte në fund të vitit të kaluar. Ndërsa grupi i bankave të vogla duket të ketë qenë më pak aktiv në tregun e depozitave gjatë kësaj periudhe, duke shënuar një peshë më të ulët ndaj totalit të depozitave, në 17.2%, nga 17.4% që rezultonte në dhjetor 2010.

Tregu i kredisë është më pak i përqendruar se ai i depozitave, duke reflektuar konkurrencë më të lartë dhe shpërndarje më të njëtrajtshme ndërmjet grupbankave. Grupi i parë i bankave zë një peshë prej rreth 40.5% të tregut të kredisë dhe rezulton i qëndrueshëm në vitet e fundit. Ndërkohë, grupi i dytë i bankave, i përbërë nga bankat greke, ka shfaqur një tkurrje të portofolit të kredisë nga 36% që ishte në mesin e vitit 2008, në 30% në shkurt të vitit 2011, ndërsa pesha e tregut të tyre në depozita ka mbetur thuajse e pandryshuar. Grupi i bankave të vogla është dominuar nga rritja e shpejtë e portofolit të tyre të kredisë duke rritur peshën e tyre në tregun e kredisë nga 14% në 2007, në 19.1 % në shkurt të vitit 2011, në një linjë me zgjerimin e aktivitetit depozitues të tyre gjatë 3-4 viteve të fundit si dhe me strategjitë e vetë bankave.

2. NDËRMJETËSIMI I SISTEMIT BANKAR

Gjatë vitit 2010 është vënë re përcjellja e stimujve të kujdesshëm monetarë dhe fiskalë në ekonomi. Në prani të një politike fiskale konsoliduese në gjysmën e dytë të vitit, politika monetare ka rezultuar kryesisht stimuluese. Ulja e normës bazë në muajin korrik, është përcjellë në tregjet financiare në muajt në vijim, të cilat u karakterizuan nga rënia e normave të interesit në pothuajse të gjithë instrumentet financiare. Ulja e normës bazë të interesit është ndjekur në një masë të gjerë edhe nga rënia e normave të interesit për depozitat dhe kreditë në lekë. Vijueshmëria e stimujve monetarë² dhe përcjellja e tyre në ekonomi kanë ndikuar në zgjerimin e kreditimit të sektorit privat në masën 9.4% mesatarisht në terma vjetorë, gjatë vitit 2010. Pavarësisht efektit statistikor të bazës së lartë krahasuese, në terma absolutë vjetorë zgjerimi i stokut total të kredisë për sektorin privat, duke përfshirë efektin e kursit të këmbimit, ka rezultuar rreth dy herë më i lartë se një vit më parë.


Në prani të presioneve të shtuara inflacioniste³ nga jashtë dhe me synim ndjekjen e një politike monetare më të kujdesshme, autoriteti monetar vendosi rritjen e normës bazë të interesit me 0.25 pikë përqindje në muajin mars të këtij viti, duke e çuar atë në 5.25 %. Pavarësisht rritjes së normës bazë të interesit, kushtet monetare në ekonomi vijojnë të mbeten stimuluese në terma historikë, në mbështetje të rigjallërimit të ekonomisë vendase. Ato janë karakterizuar nga norma të ulëta të interesave në terma realë, të cilat rezultojnë në rënie edhe në prani të presioneve inflacioniste në rritje, sidomos normat e interesit të depozitave.

Forcimi i besimit të agjentëve ekonomikë në sistemin bankar si edhe prirja e konsumatorëve drejt kursimit, kanë ndikuar në rritjen e vazhdueshme të depozitave gjatë gjithë vitit 2010 e në vijim. Reduktimi i parasë jashtë bankave dhe rikthimi i plotë i depozitave në sistemin bankar, njëkohësisht me ndërhyrjet injektuese të likuiditetit nga autoriteti monetar, kanë ndikuar në rimonetizimin e ekonomisë dhe sigurimin e zhvillimit normal të aktivitetit në tregjet financiare në vend. Banka e Shqipërisë ka vazhduar të jetë aktive në tregun ndërbankar, megjithëse në një shkallë më të ulët se gjatë vitit 2010. Kështu, autoriteti monetar ka injektuar mesatarisht rreth 14 miliardë lekë në muaj, gjatë tremujorit të parë të këtij viti, kundrejt mesatares prej rreth 29 miliardë në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe rreth 23 miliardë lekë gjatë vitit.

² Norma bazë e interesit është ulur me 1.25 pikë përqindje që nga përhapja e efekteve të krizës globale në Shqipëri, përmes tre ndryshimeve që pësoi ajo në periudhat janar '09, nëntor '09 dhe korrik '10.

³ Norma vjetore e inflacionit në muajin shkurt rezultoi në 4.5 %


Shkalla e rimonetizimit të ekonomisë është pasqyruar në rritjen e peshës së stokut total të depozitave ndaj parasë së gjerë në 81%, nga rreth 80% që rezultonte në fund të muajit dhjetor 2010, duke reflektuar kështu dhe situatën e përmirësuar të likuiditetit në sistemin bankar. Kështu, zhvillimet në kahun e ofertës konfirmojnë për një zgjerim të stokut të depozitave me rreth 7 miliardë lekë që nga muaji dhjetor, ose rreth 16.2% mesatarisht në terma vjetorë, gjatë muajve janar dhe shkurt. Rritja është përqendruar tërësisht në muajin janar, e ndjekur nga një reduktim me rreth 2.7 miliardë lekë, e stokut të depozitave në muajin shkurt. Zhvillimet në depozita, sipas agjentëve ekonomikë, konfirmojnë rritjen e qëndrueshme të depozitave të individëve, përkundrejt reduktimit të depozitave të biznesit, kryesisht në muajin shkurt, duke reflektuar sezonalitetin e aktivitetit të tyre të ulët gjatë kësaj periudhe të vitit. Shtimi i depozitave në sistemin bankar është shoqëruar me reduktimin e peshës së parasë jashtë bankave ndaj treguesit të parasë në lekë, M2, në 30.7 % në fund të muajit shkurt, nga 33.3% që rezultonte mesatarisht gjatë vitit 2010. Ecuria e këtij raporti në vite është një tregues i mirë i preferencës së agjentëve ekonomikë për mbajtjen e mjeteve monetare likuide. Reduktimi i këtij treguesi gjatë vitit të fundit dëshmon kërkesën në rënie të agjentëve ekonomikë për para cash, duke reflektuar edhe e shkallën e zhvillimit të shërbimeve bankare në një hark kohor më të gjatë.



Ndërmjetësimi i sistemit bankar për ekonominë, përfaqësuar nga raporti i stokut total të kredisë ndaj depozitave, vijon të mbetet relativisht i ulët. Në fund të muajit shkurt, raporti i kredisë ndaj depozitave në total rezultoi në 61.7%, duke shënuar një rritje të lehtë në krahasim me 61.5% që ishte në dhjetor të vitit të kaluar, por më i ulët kundrejt rreth 69 % që shënonte në muajin maj 2009. Rënia e ndërmjetësimit në terma afatmesëm reflekton përveçse rritjen e shpejtë të depozitave në sajë të rikthimit të plotë të tyre që në gjysmën e parë të vitit 2010, edhe ritmin e moderuar të zgjerimit të kredisë për ekonominë.

Norma vjetore e rritjes së kredisë për ekonominë shënon mesatarisht rreth 9.1 % gjatë dy muajve të parë të vitit, kundrejt mesatares prej rreth 8.6 % që shënoi vitin e kaluar. Ndërsa kredia për sektorin privat pësoi një rritje relativisht më të shpejtë me rreth 10.1 % mesatarisht në dy muajt e parë të vitit. Në terma absolutë, stoku i kredisë për sektorin privat u zgjerua me rreth 6 miliardë lekë kryesisht në mbështetje të bizneseve në vend. Huadhënia për bizneset ka qenë kryesisht në valutë dhe e orientuar për qëllime investimi.


Grafik 3. Ecuria e kreditit të brendshëm dhe ndryshimet tremujore të KSP.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Por megjithë shenjat për një rigjallërim të mundshëm, ritmet e kreditimit të ekonomisë vijojnë të jenë të ngadalta dhe nën mesataren e tyre historike, duke reflektuar jo vetëm kërkesën e moderuar për para por edhe sezonalitetin e sjelljes së saj gjatë muajve të parë të vitit.

Grafik 4. Rritje vjetore e kredisë për sektorin privat dhe pretendimeve neto ndaj qeverisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Njëkohësisht, kredia dhënë për individët vijon të mbetet ende e ulët, duke zënë vetëm 12% të rritjes së stokut në total, në dy muajt e parë të vitit. Ritmet e moderuara të kreditimit të ekonomisë i atribuohen kryesisht kërkesës ende të ulët të agjentëve ekonomikë në kuadrin e një aktiviteti të ngadalësuar të ekonomisë në vend standarteve të kreditimit, të cilat pavarësisht lehtësimit në muajt e fundit, vijojnë të mbeten relativisht të shtrënguara, si edhe pasigurive të zhvillimeve në të ardhmen.

Konsolidimi fiskal në gjysmën e dytë të vitit 2010 ndikoi në ritmet rënëse të huamarrjes së sektorit publik nga sistemi bankar, më e theksuar gjatë dy muajve të fundit të vitit. Njëkohësisht emetimi i eurobond-it të parë shqiptar⁴ në tregjet ndërkombëtare në muajin tetor, reduktoi nevojën e qeverisë për huamarrje të brendshme. Kështu, pretendimet neto ndaj qeverisë u rritën me mesatarisht 7.5% në terma vjetorë në gjysmën e dytë të vitit, dhe vetëm 1.3% në muajt nëntor e dhjetor. Ndërkohë, në muajt e parë të këtij viti është vënë re një rritje më e shpejtë e huamarrjes së sektorit publik, në sajë të një politike fiskale më ekspansioniste në sajë të nevojave më të larta të qeverisë për financim. Kështu, pretendimet neto ndaj qeverisë janë rritur në terma vjetorë me 2.6% dhe 4%, përkatësisht në muajt janar dhe shkurt. Huamarrja e jashtme dhe flukset e larta valutore nga jashtë gjatë vitit 2010, kanë ndikuar strukturën valutore të agregatit M3, duke mbështetur dhe rritjen më të shpejtë të tij kundrejt agregatit në lekë M2. Megjithatë, në dy muajt e parë të vitit vërehet një ngadalësim në ritmet e treguesit të parasë së gjerë, në mesatarisht 11.2%, kundrejt rreth 12.1% në tremujorin e fundit të vitit 2010. Këto zhvillime reflektojnë sezonalitetin e kontributit më të ulët të përbërësit valutore gjatë muajve të parë të vitit. Ndërkohë, aktiviteti në rritje i sektorit publik në monedhë vendase ka ndikuar në ritmet e përshpejtuara të agregatit M2 gjatë kësaj periudhe, në 5.4 % mesatarisht vit, mbi vit nga 4.7 % që rezultonte tremujorin e kaluar.

⁴ Në shumën prej rreth 300 milionë euro


3. ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT BANKAR

Ndërmjetësimi bankar në dy muajt e parë të vitit 2011, ishte në të njëjta nivele si në tremujorin e fundit të vitit 2010, duke reflektuar zhvillime të balancuara të kredisë dhe depozitave, si në lekë, ashtu edhe në euro. Marzhet e ndërmjetësimit kanë patur luhatshmëri të lartë mujore, por ecuria e tyre tregon për sinjale të rënies për monedhën euro dhe qëndrueshmëri relative në terma mesatarë për monedhën lekë. Elementët jokosto të kushteve të kreditimit, me përjashtime të veçanta, në përgjithësi vazhdojnë të jenë të shtrënguar.

3.1. ECURIA E NDËRMJETËSIMIT NË LEKË

Raporti i ndërmjetësimit në lekë në dy muajt e parë të vitit 2011, qëndroi i pandryshueshëm në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2010, mesatarisht në nivelin 38.2%, duke treguar për një balancim të rritjes së kredisë në lekë dhe asaj të depozitave në lekë. Zgjerimi mujor i kredisë në lekë, këto dy muaj, ka qenë me të njëjtat ritme mesatare si në vitin 2010. Në muajin shkurt, rritja vjetore e saj qëndron në nivelin 12.4%, nga 11.9% që qëndronte në fund të vitit të kaluar. Në përgjithësi, kredia në lekë është ndikuar nga të gjithë faktorët që kanë përcaktuar ecurinë e kreditimit të ekonomisë: një kërkesë e ulët për kredi dhe kushte kreditimi ende të shtrënguara në terma relativë. Por, përtej këtyre faktorëve, ecuria e kredisë në lekë është prekur edhe nga kushtet e kërkesës dhe ofertës në valutë, të cilat kanë favorizuar rritjen e kreditimit në monedhë të huaj, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit 2010. Nga ana tjetër, edhe kërkesa për kredi në valutë është rritur, me stabilizimin e kursit


Grafik 5. Ecuria e ndërmjetësimit në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

të këmbimit, ndërkohë që diferenca e normave të interesit vazhdon të jetë një faktor i rëndësishëm në preferencën e agjentëve ekonomikë për kredi në valutë. Pësha e kredisë në lekë ndaj totalit, në fund të muajit shkurt, është 36.0%, duke qëndruar thujtë e pandryshuar.

Zhvillimet në depozita në monedhë vendase vazhdojnë të ndikohen nga rritja e tendencës për kursim të individëve. Ato janë zgjeruar mesatarisht me 4.5 miliardë lekë në periudhën janar-shkurt të vitit 2011, kundrejt zgjerimit mesatar prej 3.4 miliardë lekësh të shënuar në tremujorin e fundit të vitit 2010. Rritja vjetore e depozitave në lekë është stabilizuar në 11.4% në këtë periudhë, duke shënuar një rritje të lehtë nga niveli 10.9% i regjistruar në dhjetor të vitit të kaluar.



Kostoja e ndërmjetësimit në lekë është rritur në dy muajt e parë të vitit 2011. Në terma mesatarë, ajo rezultoi 8.4% në këtë periudhë, kundrejt 7.2% në tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Ndërkohë që norma mesatare e depozitave ka qëndruar e pandryshuar në 5.0%, shkak i rritjes së kostos së ndërmjetësimit në këtë periudhë është rritja e kostos së kredisë. Kjo e fundit rezultoi 13.4% në terma mesatarë, nga 12.2% që shënonte në tremujorin e katërt të vitit 2010. Megjithatë, normat mesatare të ponderuar të interesit të kredive dhe depozitave ndikohen ndjeshëm edhe nga politika afatshkurtra të ndjekura nga bankat në shërbim të klientëve specifikë, gjë që reflektohet edhe në luhatshmëri të shtuar të normave të interesit, e për rrjedhojë, edhe të kostos së ndërmjetësimit. Në qoftë se do të përjashtonim nga llogaritja kredi apo depozita të veçanta, me norma interesi shumë të ndryshme nga tregu, atëherë kostoja e ndërmjetësimit rezulton në nivele të njëjta si edhe në tremujorin e katërt të vitit të kaluar.

Elementi kryesor që ka ndikuar në rritjen e kostos së kredisë në dy muajt e parë të vitit 2011 është rritja e normës së interesit për paradhëniet bankare dhënë bizneseve, e cila është rritur ndjeshëm, veçanërisht në muajin shkurt. Norma mesatare e ponderuar e interesit për këtë lloj kredie, është ndikuar


ndjeshëm nga ecuria e normave të interesit në një bankë të sistemit. Duke përjashtuar këtë bankë, vihet re niveli i normave të interesit është pranë nivelit të fundvitit 2010.

3.2. ECURIA E NDËRMJETËSIMIT NË VALUTË⁵-EURO

Rënia e vazhdueshme e raportit të ndërmjetësimit në euro, e nisur në gjysmën e dytë të vitit 2009, duket se është ndërprerë në tremujorin e katërt të vitit 2010. Në terma mesatarë, ky raport qëndroi thuhetse i pandryshuar në janar-shkurt 2011, duke regjistruar vlerën 84.5%, nga 84.4% që shënonte në tremujorin e katërt të vitit të kaluar, i cili përfaqëson edhe nivelin më të ulët të këtij treguesi⁶. Qëndrueshmëria e ndërmjetësimit në euro në fillim të vitit, ka ardhur si pasojë e ndryshimeve të vogla në stokun e depozitave dhe kredisë në monedhë të huaj në këtë periudhë dy-mujore.

Kreditimi në valutë i ekonomisë në dy muajt e parë të vitit 2011, ka qenë më i ngadaltë se në tremujorin e katërt të vitit të kaluar, por i krahasueshëm me tremujorët e mëparshëm të tij. Ajo është zgjeruar mesatarisht me 0.7 miliardë lekë dhe është ndikuar nga qarkullimi i lartë i kredisë në valutë dhënë bizneseve për kapital qarkullues, veçanërisht në muajin janar. Në terma vjetorë, rritja e kredisë në valutë shënoi 7.3%, lehtësisht më shumë se rritja prej 7.1% e shënuar në dhjetor. Burimi kryesor i kërkesës për kredi në valutë mbeten bizneset, kryesisht për financimin e investimeve. Nga ana tjetër, kredia në valutë për individët vijon të tkurret, si rrjedhojë e kujdesit të shtuar si të individëve, ashtu edhe të vetë bankave, ndaj rrezikut indirekt të kursit të këmbimit.

Grafik 7. Ecuria e ndërmjetësimit në euro.




⁵ Veprimtaria e bankave në valutë është e dominuar nga aktiviteti i tyre në euro, i cili zë më shumë se 80% të aktivitetit në valutë.

⁶ Të gjitha shifrat e pasqyruara këtu janë të pastruara nga efekti i kursit të këmbimit.

Në fund të muajit shkurt, stoku i depozitave në valutë rezultoi i tkurrur në krahasim me fundin e vitit 2010, me rreth 6.2 miliardë. Kjo rënie erdhi si pasojë e përdorimit të depozitave nga bizneset për përmbushjen e nevojave të tyre për likuiditet, në këtë periudhë të vitit. Rritja vjetore e depozitave u rrit në 25.5% në dhjetor, dhe ra më pas në 22.3% dhe 20.3% përkatësisht në janar dhe shkurt të vitit 2011.

Grafik 8. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në euro.



Përtej luhatshmërisë mujore, në ecurinë e marzhit të ndërmjetësimit në euro janë shfaqur shenja të rënies në tremujorin e katërt të vitit 2010 dhe dy muajt e parë të vitit 2011. Në terma mesatarë, ai rezultoi përkatësisht 5.2% dhe 4.8%. Rënia në tremujorin e katërt i dedikohet lëvizjes në rënie si të normës mesatare të interesit të depozitave, ashtu edhe të asaj të kredisë. Ndërkohë, në muajt janar-shkurt, norma e interesit të depozitave ka qëndruar e pandryshuar në krahasim me tremujorin e katërt të vitit, dhe rënia e kostos së ndërmjetësimit në monedhën euro i dedikohet rënies së normës së interesit të kredisë, ardhur si pasojë e rritjes së konkurrencës mes bankave.


Normat e interesit të depozitave në monedhën euro janë më të larta në vend, në krahasim me normat e interesit në tregun evropian ndërbankar, duke reflektuar edhe veçori të tregut vendas. Në mënyrë që bankat të mund të mbulojnë koston e depozitave dhe të sigurojnë një fitim normal në aktivitetin e tyre, spread-i mes interesit të kredive në euro në vend dhe normave të interesit të euros në tregun evropian është i lartë.

3.3. ECURIA E ELEMENTEVE JOKOSTO NË NDËRMJETËSIM

Përveç çmimit të kredisë, normës së interesit, për ecurinë e kreditimit janë shumë të rëndësishëm edhe kriteret e tjera të përdorura nga bankat, të cilat kushtëzojnë ofertën dhe kërkesën për kredi.

Në tremujorin e parë të vitit 2011, kushtet e kreditimit për bizneset u lehtësuan në të njëjtën masë si edhe në tremujorin e mëparshëm. Elementi jokosto që ka vepruar në kahun lehtësues ishte shuma maksimale e kredisë, ndërkohë që të gjithë faktorët e tjerë janë shtrënguar, por në një masë më të vogël se tremujorin e mëparshëm.


Grafik 9. Ecuria e kushteve të kreditimit për bizneset*



*Balanca neto e përgjigjeve në këtë vrojtim.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lehtësimi i kushteve të kreditimit për individët i kryer në tremujorin e katërt të vitit të kaluar, është pasuar nga një lehtësim i mëtejshëm në tremujorin e parë të vitit 2011, por në një masë më të vogël. Sikurse raportohet nga bankat, përveç uljes së marzhit të interesit, në kahun lehtësues në këtë tremujor ka vepruar edhe ulja e komisioneve. Një pjesë e efektit lehtësues të këtyre dy elementëve është balancuar nga shtrëngimi i elementëve të tjerë jokosto: ulja e madhësisë së kredisë së dhënë, rritja e kërkesave për kolateral, ulja e raportit këst/të ardhura.


Grafik 10. Ecuria e kushteve të kreditimit për individët.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4. NDËRMJETËSIMI BANKAR NË VENDET E RAJONIT⁷

Përhapja e efekteve të krizës financiare të fundit të vitit 2008, fillimisht në sektorin financiar dhe më pas në të gjithë sektorët e ekonomisë, ndikoi në normat e ulëta të aktivitetit ekonomik në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Gjatë vitit 2010, u vërejtën shenjat e para të rikuperimit të kushteve në tregjet financiare dhe të treguesve financiarë e monetarë, falë ndërhyrjeve të bankave qendrore dhe politikave fiskale akomoduese. Të dhënat paraprake të muajve të parë të vitit 2011, rikonfirmojnë kalimin zyrtar të recesionit ekonomik nga këto vende, të cilat kanë vijuar të shënojnë norma të qëndrueshme të rritjes ekonomike. Megjithatë, ekspansioni monetar në vendet e EQL-së vijon të mbetet i ulët. Rritja ekonomike që ka pasuar në këto vende, duket të jetë e mbështetur kryesisht nga zhvillimet pozitive në sektorin e jashtëm dhe më konkretisht nga rritja e eksporteve. Ndërsa kreditimi i ekonomisë nga sistemi bankar vijon të mbetet ende i ulët pavarësisht rikuperimit të ritmeve rënëse dhe normave të lehta në rritje që janë shënuar edhe gjatë dy muajve të parë të vitit 2011*.



Të gjitha vendet kanë shfaqur shenja rikuperuese të kreditimit të ekonomisë, përfshirë edhe Malin e Zi dhe Hungarinë, të cilat pavarësisht se shënojnë ende norma rënëse, ato rezultojnë në kahun ngadalësues. Kështu, kredia për ekonominë në Hungari, nga një rënie me mbi 10 % në mars të vitit të kaluar, po rikuperon duke shënuar norma vjetore pranë zeros. Sipas Bankës së Hungarisë, kërkesa e ulët për kreditim afatgjatë është ndikuar nga vendimet për

⁷ Material periodik i Deutsche Bank për Evropën Lindore, Tetor 2010. Vendet e rajonit në shqyrtim janë: IRJ e Maqedonisë, Serbia, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Turqia, Rumania, Bullgaria, Polonia, Çekia dhe Hungaria.

shtyrjen e investimeve kapitale nga ana e bizneseve, ndërsa ajo e individëve, nga niveli i të ardhurave të tyre të disponueshme. Ndërkohë, normat vjetore të kreditimit në Malin e Zi, pavarësisht ngadalësimit, vijojnë të mbeten ende në territor negativ dhe nën mesataren e tyre historike. Serbia vazhdimisht ka shënuar norma mesatare dukshëm më të larta se në vendet e tjera të rajonit. Ritmet e kreditimit të ekonomisë po rikuperohen në mënyrë të qëndrueshme, duke reflektuar veçanërisht rritjen e kredisë për biznese në tremujorin e katërt. Duke iu referuar raporteve të Bankës së Serbisë, bankat në vend kanë financuar aktivitetin e tyre kreditues si nëpërmjet burimeve të brendshme në sajë të zgjerimit të stokut të depozitave, ashtu edhe nëpërmjet burimeve të huaja në sajë të huamarrjes së jashtme. Polonia gjithashtu ka shënuar ritme të kënaqshme të kreditimit të ekonomisë, në një masë të konsiderueshme e mbështetur nga kredia për bizneset, kryesisht ato të vogla dhe të mesme, të cilat janë më pak të varura nga financimi me burime të jashtme. Vendet e tjera si Kroacia, Çekia dhe Bosnjë-Hercegovina kanë ruajtur normat pozitive dhe të moderuara të kreditimit të ekonomisë të shënuara në tremujorin e fundit të vitit 2010.







Gjatë periudhës së krizës financiare globale, normat e ndërmjetësimit⁸ bankar rezultuan përgjithësisht me rënie. Këto zhvillime reflektuan ngadalësimin e ndjeshëm të kreditimit kundrejt ritmeve më të shpejta të zgjerimit të depozitave gjatë kësaj periudhe. Ecuria e normave të ndërmjetësimit në vijim në shumicën e vendeve të EQL-së vërejt një rritje të lehtë gjatë vitit 2010, kryesisht gjatë gjysmës së dytë të vitit. Rikuperimi i stokut të kredisë dhe rikthimi me ritme më të ulëta i depozitave në sistemin bankar gjatë kësaj periudhe – të tërhequra gjatë periudhës së krizës financiare dhe të kthyer kryesisht gjatë vitit 2009 dhe pjesës së parë të vitit 2010– ndikuan në rritjen e normave të ndërmjetësimit. Ndërkohë, normat e ndërmjetësimit në muajt e parë të vitit 2011 duket të kenë ruajtur në masë të njëjtat raporte si në fundin e vitit të kaluar. Stimuli monetar parashikohet të ripërtërihet pas një rigjallërimi të kërkesës së sektorit privat të ekonomive të EQL-së, duke ndikuar kështu edhe në rigjallërimin e aktivitetit ekonomik në këto vende.

Me stabilizimin e krizës financiare globale, përmirësimin e situatës së likuiditetit dhe funksionimin normal të tregjeve financiare, rigjallërimin e aktivitetit ekonomik dhe shenjat pozitive për rritjen e kërkesës agregate të agjentëve ekonomikë, në prani edhe të presioneve të shtuara inflacioniste, në muajt e parë të vitit 2011 një pjesë e mirë e bankave të rajonit kanë ndryshuar normat bazë të interesit në kahun rritës. Kështu, Banka e Polonisë ka rritur dy herë normën e saj bazë të interesit me nga 0.25 pikë përqindje përkatësisht në muajt janar dhe prill, duke e çuar atë në 4 %. Të njëjtën politikë në kahun shtrëngues ka ndjekur edhe Banka e Serbisë e cila ka rritur tre herë normën e saj bazë që nga fillimi i vitit -0.5 pikë përqindje në muajin janar, 0.25 pikë përqindje në muajin mars dhe së fundmi, me 0.25 pikë përqindje në muajin prill- duke e çuar kështu normën bazë në 12.5 %. Njëkohësisht me vendet e rajonit, Banka Qendrore Evropiane dha gjithashtu sinjale për shtrëngim të politikës së saj monetare me rritjen e normës bazë me 0.25 pikë përqindje, duke e çuar atë në 1.25 % në fillim të muajit prill. Ndërkohë, Banka Qendrore

⁸ Përfaqësohet nga raporti i kredisë në total për ekonominë, ndaj stokut total të depozitave







e Maqedonisë vijon të mbajë të pandryshuar normën e vet bazë të interesit në 4% që pas reduktimit të saj të fundit me 50 pikë përqindje në muajin dhjetor të vitit të kaluar, por pritet të hyjë në një cikël shtrëngues të politikës monetare në fillim të muajit qershor.

Aneks A. Ecuria e depozitave



Burimi: Banka e Shqipërisë

Aneks B. Ecuria e portofolit të kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë

